

**Në dt. 24 gusht (që në dt. 23 gusht në mbrëmje)  
Kisha Orthodhokse feston Hierodëshmor  
Kozmain e Kolkondasit (apo siç njihet edhe më  
gjerë si Sh. Kozma Etolosin).**



Nderimi i tij si shenjtore lokal nisi në shek. XVIII, në të gjitha ato zona ku ai dha një kontribut të jashtëzakonshëm në zgjimin e ndërgjegjes së shtypur të orthodhoksëve nga nata e gjatë osmane, duke frenuar dukshëm islamizimin e këtyre trevave. Këtë e dëshmojnë ndërgjegjja e popullit orthodhoks shqiptar, afresket e ikonat, shërbesa kishtarë për shenjtorin, Manastiri i tij ndërtuar nën kujdesin e Ali Pashë Tepelenës (1814-1815) dhe mbi të gjitha, e dëshmon nderimi i madh i gjithë popullit edhe atij joorthodhoks, kudo ku ai predikoi.

Dëshmi e këtij nderimi para vitit 1961, që hedh poshtë ato që pretendojnë antiorthodhoksët, mes shumë të tjerave, është ajo që kanë shkruar e botuar dy nga personalitet më të mëdha të Kishës sonë: Imzot Theofan Noli dhe Kryepiskopi i parë kanonik, Fortlumturia e Tij Kristofor Kisi.

Imzot Theofan Noli, në vitin 1947, në Boston, botoi Kremtoren (Të kremtet) e Kishës Orthodokse. Në parathënien e tij thotë se: “Përkthimin... e kemi bërë nga Gerqishtja, me përjashtimin e këndimeve të Shën Kozmait të Beratit, të cilin e parafrazuam nga versionin shqip i KryeHirësisë së Tij, Imzot Kristofor Kisi, Kryepeshkopit të Shqipërisë”. Dhe në faqet 754-763 jep shërbesën kishtare të këtij shenjtori (që ne sapo e kemi postuar sot para pak orësh, po këtu në fb).

Pra, Imzot Theofan Noli, që në 1947 (pra përpara viti 1961) e quan Shën Kozmai i Beratit dhe shërbesën e shenjtorit e merr nga botimi i vitit 1931 të Imzot Kristofor Kisit, i cili ka shkruar mjaft për Shën Kozmain.

Për Imzot Theofan Nolin dhe Imzot Kristofor Kisin, Shën Kozmai nuk ishte as antishqiptar e as “joshenjtor”, siç trumbetojnë disa zotërinj antiorthodhoksë.

- Afresk i shën Kozmait, shek. XIX, në Manastirin që i dedikohet po këtij shenjtori.
- Kopertinë e librit të Imzot Kristoforit për shën Kozmain “Jetëshkrimi dhe akoluthia e dëshmorit të ri dhe Isapostullit Shën Kozma”, Korçë 1931.
- Fragmente nga libri i Imzot Theofan Nolit, “Kremtore e Kishës Orthodokse”, Boston, 1947 (Libri liturgjik që përdorim sot në kishat orthodhokse të Shqipërisë)

Manastiri i Shën Kozmait u ndërtua nën kujdesin e Ali Pashë Tepelenës (1814-1815). Në shek. XX u shkatërrua pjesërisht nga përmbytja e lumit Seman. Pas vitit 1995 u rikonstruktua plotësisht me kujdesin dhe fondet e siguruar nga Kryepiskopi Anastas. Punimet e gërmimit dhe largimit të dherave nxorrën në dritë varrin e shenjtorit me pikturë murale të asaj kohe që mbi dy shekuj më parë, si dhe elemente të tjerë arkitekturorë me mjaft interes, që ishin mbuluar nga lymë i sjellë nga përmbytjet e lumit Seman.

Kjo libër, sipër titullit, përmban këndimet e te krémteve kryesore të palevizura të dymbëdhjetë mújve. Në këtë shtuam të dy Kanunet e Shen Marisë, Lutësoren dhe Dieloren, domethënë Troparet e të Tete Tingëjve me Apostujtë dhe Ungjijtë, që këndohen në të Dielat e zakonit të motit. Pothua të gjithë Troparet janë artuar pas rithmeve dhe melodive Bizantine. Përkthimin e kemi bërë lirisht, pas kuptimit edhe jo fjale pas fjale, nga Gërgishtëja me përjashtimin e këndimeve të Shen Kozmájit të Beratit, të cilat i parafrazuar nga versioni Shqip i Krye-Hiresisë Tij, Imzót Kristofór Kisi, Kryepeshkopit të Shqipërisë. Një pjesë e madhe e këtyre Tropareve botohen këtu për herën e parë. Që të gjitha këndimet, që janë botuar më parë, dalin taní në dritë të revizúara. Falenderojmë të gjithë pajtimtarët, që na përkrahën me ndihmë të përpagúara, dhe veçanërisht Federatën "Vatra" me Deget e saj, të cilat mblohtën më tepër se gjysmën e shumës totale të nevojshme për kujtimin e Faik Konitzës, lëronjësit të gjuhës Shqipe dhe çampionit të independencës kombëtare.

Perkthënjesi

Boston, Mass., Prill 25, 1947.



# **KREMTORE**

*E KISHES ORTHODOKSE*



E Përktheu Imzót Fan S. Noli  
E Botój Peshkopata e Amerikës

BOSTON, MASS.

1947

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)